



FINAC

FINancial management,
Accounting & Controlling
in public administration

Financial Management, Accounting & Controlling curricula development for capacity building of public administration

RAPORT MBI IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT FINAC ERASMUS+ NË UNIVERSITETET NË SHQIPËRI

2019

Projekti Zhvillimi i Kurrikulave në Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike – FINAC u implementua në kuadër të programit ERASMUS+ të Komisionit Evropian, nënprogramit Ngritje Kapacitetesh në fushën e Arsimit të Lartë.

Projekti u implementua në Shqipëri dhe në Serbi dhe bashkoi 12 partnerë, shumica prej të cilëve institucione të arsimit të lartë, nga gjashtë vende. Projekti u koordinua nga Universiteti i Beogradit. Objektivi kryesor i projektit ishte të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në administratën publike të Shqipërisë dhe Serbisë, nëpërmjet zhvillimit dhe modernizimit të programeve të studimit të nivelit master.

Në Shqipëri, projekti ka zhvilluar dy programe të reja të nivelit master në dy universitete (Universiteti Evropian i Tiranës dhe Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër), tre programe të reja të nivelit master dhe përditësimin e një programi ekzistues të nivelit master në universitetet në Serbi. Të gjitha programet kanë filluar në vitin akademik 2018/2019. Gjithashtu, projekti ofroi trajnime për nëpunësit civil në Shqipëri dhe Serbi.

Ky dokument do të përshkruajë arrijet kryesore të projektit në Shqipëri në kontekstin e aktiviteteve kryesore të projektit, dhe në veçanti, gjetjet e kërkimit të kryer në fillim të projektit. Kërkimi synonte identifikimin e nevojave të nëpunësve civil sa i përket njohurive dhe aftësive specifike, veçanërisht në fushat e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit.

Zhvillimet në administratën publike shqiptare karakterizohen kryesisht nga standardet ndërkombëtare, veçanërisht në ato fusha që marrin vëmendje të konsiderueshme në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Shpejtësia dhe cilësia e adoptimit dhe implementimit efektiv të sistemeve dhe praktikave të reja në administratën publike varet në mënyrë të rëndësishme nga aftësia e institucioneve përkatëse, duke përfshirë aftësitë e punonjësve të tyre. Ndaj, Projekti FINAC, si element kyç për programet e nivelit master dhe programet e shkurtra të trajnimit, ka drejtuar pjesëmarrësit e tij të zhvillojnë aftësi që i mundësojnë ata t'i përgjigjen suksesshëm pritshmërive të gjeneruara nga zhvillimet bashkëkohore në administratën publike, veçanërisht në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Për të qenë të suksesshëm në këtë detyrë, projekti FINAC u mbështet në disa burime të rëndësishme.

Zhvillimi i programeve të nivelit master dhe programeve të trajnimit u mbështet në kapacitetet akademike dhe ekspertizën që tashmë ekziston në universitetet në vend. Këta janë profesorë të mirënjohur dhe staf tjetër akademik që kanë një numër punimesh shkencore dhe eksperiencë praktike në fushat përkatëse, si dhe eksperiencë në mësim-dhënie, në bazë të të cilave ata mund të kontribuonin në krijimin e programeve të azhurnuara dhe të përshtatshëm.

Institucionet partnere të arsimit të lartë nga Bashkimi Evropian dhanë mbështetje të madhe profesionale në zhvillimin e programeve: Universiteti i Splitit, Kroaci; Universiteti Masaryk, Republika Çeke; Universiteti Matej Bel, Sllovakia; dhe Universiteti Guglielmo Marconi, Itali. Bashkëpunimi intensiv me partnerët evropian, veçanërisht në kuadër të vizitave studimore, ka bërë të mundur mbështetjen e programeve të reja në informacion të dorës së parë rreth arritjeve dhe sfidave aktuale në administratat publike të vendeve të tjera, si dhe si programet akademike në këto vende i përgjigjen pritshmërive aktuale dhe tendencave të parashikuara për të ardhmen.

Komunikimi intensiv me, dhe përfshirja aktive, e institucioneve shtetërore i mundësoi projektit FINAC të rishikojë vazhdimisht supozimet mbi të cilat u mbështetën programet e nivelit master dhe programet e trajnimeve, duke iu referuar kontekstin vendas, domethënë situatës aktuale dhe perspektivat e administratës publike, veçanërisht në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Një nga aktivitetet e para të projektit ishte një studim, i cili synonte të pajiste projektin me të dhëna të vlefshme dhe të besueshme mbi nevojat e nëpunësve civilë për zhvillim të mëtejshëm profesional në fushat me interes për projektin FINAC. Kërkimi rezultoi në një numër raportesh, që bazuar në gjetjet e kërkimit, dhanë rekomandime për zhvillimin e programeve akademike.

Ky dokument do të përshkruaj gjetjet kryesore nga fillimi i projektit. Përpara kësaj, do të prezantohen programet e reja të nivelit master dhe programet e trajnimit për nëpunësit civilë. Kjo do të tregojë se, siç ishte planifikuar, ato janë hartuar për të përmbushur nevojat e nëpunëve civilë – si nevojat aktuale ashtu edhe nevojat që lindin nga reformat e vazhdueshme e administratës publike dhe më specifikisht reformat në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.



PROGRAMET E NIVELIT MASTER TË LICENSUARA SI REZULTAT I



UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Programi i studimit	Master Profesional 'Audit'.
Data e licensimit	12.10.2018
Kohëzgjatja	Një vit (dy semestra), 60 ECTS
Titulli akademik	Master Profesional në Auditim

NR.	Titulli i lëndës	Semestër	Course status	ECTS
<i>A – Lëndë Bazë (6 ECTS)</i>				
1.	Metoda kërkimi të avancuara	I	Bazë	6
<i>B – Lëndë Karakterizuese të Programit (18 ECTS)</i>				
1.	Auditim Financiar	I	Të detyrueshme	6
2.	Analizë dhe Raportim Financiar	I	Të detyrueshme	6
3.	Kontabilitet Financiar	I	Të detyrueshme	6
<i>C – Lëndë të Profilizuara (18 ECTS)</i>				
Auditimi				
1.	Kontroll i Brendshëm dhe Audit	II	Profil	6
2.	E Drejtë e Korporatave	I	Profil	6
3.	Auditim i Institucioneve Financiare/ Bankare	II	Profil	6

NR.	Titulli i lëndës	Semestër	Course status	ECTS
	Auditimi i Institucioneve Financiare		Profil	
1.	Kontabilitet Bankar	II	Profil	6
2.	Auditimi i Institucioneve Financiare/ Bankare	II	Profil	6
3.	Tregu Bankar dhe Institucionet e tij	I	Profil	6
	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh		Profil	
1.	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	I	Profil	6
2.	Aftësi Menaxheriale	II	Profil	6
3.	Vlerësim Ekonomik Projektsh	II	Profil	6
	Kontabilitet dhe Raportim Financiar		Profil	
1.	Kontabilitet Manaxherial	I	Profil	6
2.	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar	II	Profil	6
3.	Auditimi i Institucioneve Financiare/ Bankare	II	Profil	6
	Administrimi Publik			
1.	Vlerësim i Politikave Publike	II	Profil	6
2.	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	I	Profil	6
3.	Menaxhim i Sektorit Publik	II	Profil	6
D – Praktikë (6 ECTS)		II		6
E – Punimi i Diplomës (12 ECTS)		I-II		12



UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR

Programi i studimit	Master Profesional në Menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në administratën publike
Data e licensimit	19.10.2018
Kohëzgjatja	Një vit (dy semestra), 60 ECTS
Titulli akademik	Master Profesional në Menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në administratën publike

Nr.	Emri i Lëndës	Semesteri	Lloji i Lëndës	ECTS
1.	Ekonomiksi i avancuar në sektorin publik	I	E detyruar	6
2.	Kontabiliteti i sektorit publik	I	E detyruar	6
3.	Politikat fiskale	I	E detyruar	6
4.	Menaxhimi financiar i institucioneve publike	I	E detyruar	6
5.	Kontrolli dhe auditimi në sektorin publik	I	E detyruar	6
6.	Analiza e buxhetit të shtetit	II	E detyruar	5
7.	Lëndë me zgjedhje 1	II	Me zgjedhje	5
8.	Lëndë me zgjedhje 2	II	Me zgjedhje	5
9.	Praktika Profesionale	II	Me zgjedhje	5
10.	Teza e Diplomës	II	Me zgjedhje	10

Lëndët me zgjedhje:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik
- Prokurimet publike
- Marketingu i shërbimeve dhe mjedisi elektronik
- Menaxhimi dhe modelimi financiar në sektorin publik
- Menaxhimi i riskut në institucionet e sektorit publik
- Etika në sektorin publik

TRAJNIMET E NËPUNËSVE CIVILË SI REZULTAT I PROJEKTIT FINAC



**Universiteti
European i
Tiranës**

**UNIVERSITETI EVROPIAN I
TIRANËS**

Në fund të vitit 2018, fillim 2019, në kuadër të projektit FINAC, u mbajtën trajnime për nëpunësit civil në fushat që janë në fokusin tematik të projektit. Organizator i trajnimeve ishte Universiteti Evropian i Tiranës, partner i projektit, dhe për një trajnim, bashkëpunëtor ishte Departamenti i Administratës Publike, në Këshillin e Ministrave.

Trajnim dy ditor mbi Auditimin dhe Politikat Publike (20-21. Nëntor 2018)

Modulet:

Auditimi i Performancës në Institucionet Publike dhe Kontrolli i Brendshëm

Menxhimi i Riskut

Hartimi i Politikave Publike bazuar në Evidenca

Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikave Publike

Trajnim katër ditor mbi Menaxhimin e Performancës dhe Auditimin dhe Auditin e TI (15-18. Janar 2019)

Modulet:

Auditimi i Performancës Publike

Sistemet e Kontrollit të Brendshëm në Administratën Publike

Auditimi i Sistemeve të Informacionit

Menaxhimi i Riskut të TI dhe Mjetet e Auditimit të Sistemit të Informacionit dhe Llogaridhënies të Administratës Publike

STUDIMI

METODA

Qendra për Politika në Arsim ishte partneri lider në hartimin dhe implemetimin e studimit, procesimi i të dhënave dhe shkrimi i raporteve kërkimore, u krye në bashkëpunim me të gjithë partnerët e projektit. Mbështetje specifike profesionale dhe teknike për pjesën e kërkimit të kryer në Shqipëri u dha nga Universiteti Evropian i Tiranës.

Anketa kryesore u krye nëpërmjet një ankete online në periudhën prill-qershor 2017. Pyetësi u plotësua nga nëpunësit civilë të punësuar në administratën publike – ministri, autoritete të integruara brenda ministrive, organizata speciale dhe shërbime qeveritare (zyra). Tre nën-kampionët kryesorë përbëheshin nga menaxherët e përgjithshëm, stafi i departamenteve të financës (përgjegjës njësie dhe staf në varësi), dhe auditues të brendshëm.


Pyetësi përfshinte një numër pyetjesh që trajtonin çështjet kryesore të kërkimit: menaxhimi financiar dhe kontrolli, buxhetimi i programit, implementimi i buxhetit, kontabiliteti, auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i politikave publike. Në përgjigje të këtyre pyetjeve të anketuarit shprehnin se në çfarë mase ata ishin të përfshirë në kryerjen e detyrave të listuara dhe në çfarë mase ata ndjenin se kishin nevojë për zhvillim profesional për të qënë më të suksesshëm në kryerjen detyrave. Çdo target grup iu përgjigj një kombinimi të caktuar pyetjesh, të përshtatura sipas aftësive specifike. Një numër prej 172 nëpunësish civilë plotësuan anketën.

Një segment tjetër i kërkimit ishin intervistat gjysmë të strukturuar – ato u zhvilluan për të fituar njohuri se si e perceptojnë nëpunësit civilë qëllimin dhe çfarë kuptime personalu u veshin ata zhvillimeve bashkëkohore në administratën publike. Çështjet e mbuluara ishin të njëjtat si në pyetësor. Theksi u vendos mbi të kuptuarin e efektivitetit të proceseve, identifikimit të sfidave më të mëdha dhe aftësitë që duhet të zhvillojnë më tej nëpunësit civilë. Intervistat u zhvilluan me 18 nëpunës civilë (katër menaxherë të përgjithshëm, tetë auditues të brendshëm dhe gjashtë menaxherë/oficerë të njësive të financës) që vinin prej 10 ministrive të ndryshme dhe zyrës së Kryeministrit. Intervistat u zhvilluan gjatë majit dhe qershorit 2017.

MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK) në këtë kërkim kuptohet si një sistem politikash, procedurash dhe aktiviteteve të krijuara, mirëmbajtura dhe të përditësuara rregullisht nga organizata, të cilat japin siguri të mjaftueshme që qëllimet e organizatës do të arrihen në një mënyrë të ligjshme, të përshtatshme, ekonomike, efikase dhe efektive. Në këtë studim, nevojat për trajnim të nëpunësve civilë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit u analizuan nëpërmjet kuadrit COSO, të përbërë nga pesë elemente të ndërlidhur: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi edhe komunikimi dhe monitorimi dhe vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rezultatet e kërkimit tregojnë se menaxherët e përgjithshëm tentojnë të jenë më pak të angazhuar në segmentin e aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut në krahasim me aspektet e tjera të MFK. Në lidhje me nevojat e perceptuara për zhvillim të mëtejshëm profesional, për shumicën e praktikave më shumë se 50% e menaxherëve të përgjithshëm u shprehën se kanë nevojë të një niveli të lartë ose të moderuar për zhvillim të mëtejshëm profesional për të kryer këto praktika në mënyrë më efektive. Për një numër praktikash kjo përqindje shkoi deri në 70% ose më lartë.



Pothuajse për të gjitha praktikantët në fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk pati menaxherët të përgjithshëm që thanë se ato nuk ishin në lidhje me pozicionin e tyre të punës. Menaxherët e financës shprehën më pak nevojë për zhvillim profesional në menaxhimin e riskut dhe aktivitetet e kontrollit sesa menaxherët e përgjithshëm. Vetëm për disa praktika ata shprehën nevojë të nivelit të lartë për trajnim: Përdorimi i formularit të menaxhimit të riskut, Planifikimi i emergjencës, dhe Identifikimi i risqeve financiare.

Intervistat e zhvilluara me nëpunësit civilë treguan se menaxhimi financiar dhe kontrolli kuptohen si të rëndësishme parësore. Fushat kryesore ku nevojitet zhvillim i mëtejshëm profesional janë vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i riskut në përgjithësi. Në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit, digjitalizimi i proceseve të caktuara shikohej si një mënyrë për të përmirësuar kontrollet parandaluese, rrjedhën e informacionit dhe modelet e komunikimit (duke përfshirë ato ndër-sektoriale). Kjo nga ana tjetër me siguri do të vendos kushte të rëndësishme për zhvillimin profesional të nëpunësve civilë.



PROGRAMIMI I BUXHETIT

Programi buxhetit është një tjetër mekanizëm efektiv që mundëson menaxhim më të mirë të performancës së administratës publike, duke theksuar vendosjen e prioriteteve dhe optimizimin e shpenzimeve, me përgjegjësi të shtuar për përdoruesit e buxhetit dhe transparencën e shpenzimeve.

Rezultatet tregojnë se shumë menaxher të përgjithshëm nuk angazhohen ose nuk e shohin programimin e buxhetit si një praktikë në lidhje me punën e tyre. Megjithatë, shumë prej tyre shprehin nevojën për zhvillim profesional në buxhetimin e programit. Për pothuajse të gjitha praktikatat më shumë se 50% e menaxherëve të përgjithshëm, që i kuptojnë ato si pjesë të punës së tyre të zakonshme, u shprehën se kanë nevojë të nivelit të lartë ose të moderuar për trajnim shtesë. Për një numër praktikash, këto përqindje ishin mjaft të larta – më shumë se 70% e të anketuarëve.

Pesë praktikatat e buxhetimit të programit me nevojat më shpesh të shprehura për zhvillim profesional

Menaxherët e financës	Departamentet e financës
Zhvillimin e strukturës së programit të buxhetit	Përcaktimi i qëllimit të një programi, aktiviteti programi ose projekti
Përcaktimin e objektivave të programit duke i'u referuar kriterit SMART	Caktimi i treguesve të performancës të cilët sigurojnë informacionin mbi efektivitetin dhe efikasitetin e programeve, aktiviteteve të programeve dhe projekteve
Analizimi se si arritja e objektivave mund të matet në mënyrën më të përshtatshme dhe praktike	Prioritarizimi i shpenzimeve dhe rrjedhjeve për aktivitetet e programit ose projektit të ardhshëm
Përcaktimi i treguesve që masin cilësinë e shërbimeve të ofruara	Përfshirja e fondeve të asistencës para-anëtarësimit të BE-së (IPA) në buxhetin e programit
Përcaktimi i treguesve të efikasitetit	Caktimi i kostove direkte

Punonjësit në departamentet e financës shprehën më rrallë se praktikatat e buxhetimit të programit nuk ishin në lidhje me punën e tyre. Për secilën prej praktikave të paktën 40% e të anketuarëve nga departamentet e financës u shprehën se kanë nevojë të nivelit të lartë ose të moderuar për zhvillim të mëtejshëm profesional. Megjithatë, vetëm si përjashtim ishte një praktikë ku më shumë se 60% të të anke-

tuarëve u shprehën se kishin nevojë të një niveli të lartë dhe mesatar për zhvillim profesional.

Buxhetimi i programit në Shqipëri është në proces zhvillimi dhe në këtë aspekt, intervistat tregojnë se fusha kryesore e zhvillimit është futja e metodologjisë së re për hartimin e buxheteteve të programeve. Në lidhje me zhvillimin profesional sfida kryesore është qëndrueshmëria e aftësive të fituara, pjesërisht për shkak të lëvizshmërisë së lartë të forcës punëtore në administratën publike. Për më tepër, buxhetet e programeve shpesh kërkojnë koordinim dhe komunikim ndër-sektorial dhe zhvillimi i aftësive në këtë drejtim është i nevojshëm.


Në fushën e përcaktimit të treguesëve të performancës, sfida kryesore shihet në lidhje me specifikimin dhe operacionalizimin. Për më tepër, procesi i digitalizimit të mëtejshëm në administratën publike shihet si i dobishëm në këtë aspekt. Në fushën e monitorimit dhe raportimit të vlerave të arritura nëpërmjet përdorimit të indikatorëve të zgjedhur, gjetjet nga intervistat tregojnë se raportimi sistemik i performancës është jashtëzakonisht i rëndësishëm.



IMPLEMENTIMI I BUXHETIT, KONTABILITETI DHE RAPORTIMI

Të anketuarit nga departamentet e financës, sic pritej, shpesh u shprehën se ata ishin të përfshirë në të gjitha praktikat e implementimit të buxhetit, shpesh në një masë të madhe. Në lidhje me nevojat e përceptuara për zhvillim profesional, nga 38% në 64% të të anketuarëve u shprehën se kanë nivele të larta ose të moderuara të kësaj nevojë. Implementimi i procedurave të menaxhimit financiar të fondeve të BE-së ishte fusha në të cilën më shpesh nevojitet zhvillim profesional.

Mes praktikave që u përmendën më shpesh në fushën e implementimit të buxhetit, si praktikat që duhen zhvilluar më shumë, janë: Planifikimi i implementimit të buxhetit në bazë ditore dhe mujore, Menaxhimi i ndarjeve të buxhetit dhe kuota-ve, Sigurimi i saktësisë së klasifikimit të buxhetit, Përgatitja e raporteve mbi implementimin e buxhetit, dhe Sigurimi i përshtatshmërisë së dokumentacionit të paraqitur për lindjen e detyrimeve.



Rezultatet treguan se të gjitha ato praktika të lidhura me praktikat e kontabilitetit dhe prodhimit të deklaratave financiare janë pjesë e punës së zakonshme të punonjësve në departamentet e financës, dhe në shumicën e rasteve ata marrin pjesë në këto praktika në një masë të madhe. Për të gjitha praktikat, nga 40% në 62% të

stafit të departamenteve të financës u shprehën se ata kanë nivele të larta/moderuar nevojë për zhvillim profesional që t'i kryejnë ato praktika më efektivisht. Në fushën e kontabilitetit të menaxhimit, në shumicën e rasteve stafi i departamentit të financës u shpreh se këto praktika janë pjesë e punës së tyre, d.m.th ata janë të përfshirë në implementimin e tyre. Kjo mund të duket si e papritur, meqënëse disa nga ato praktika përfaqësojnë punë analitike, e cila shpesh është e nënpendorur në administratën publike. Nevojat për trajnim profesional në këtë fushë ishin më pak të spikatura se sa në setet e mëparshme të praktikave – për të gjitha praktikat pohimet për nevoja të nivelit të lartë dhe mesatar varionin nga 33% në 55%. Niveli më i lartë i nevojës për zhvillim u gjet në praktikat në vijim: Kryerja e analizës së trendit, Kryerja e analizës kosto-përfitim dhe analizës kosto-efiçencë, dhe Analizimi i deklaratave financiare të përdoruesve indirektë të buxhetit.



AUDITIMI I BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, që siguron arritjen e objektivave dhe konsultativ, i hartuar për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ndhmon organizatën të arrijë qëllimet e saj duke vlerësuar në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar menaxhimin e riskut, kontrollin dhe menaxhimin e organizatës. Rezultatet tregojnë se, në përgjithësi, audituesit e brendshëm shpesh kanë mendimin se ata kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm profesional – mesatarisht, kjo është më e shpeshtë se sa në nënkampionët e tjerë. Vetëm si përjashtim, ka një praktikë të auditimit të brendshëm për të cilën më pak se 50% e audituesve të brendshëm ndjejnë se kanë nevojë të nivelit të lartë dhe mesatar për zhvillim profesional. Si rregull, këto përqindje janë dukshëm më të larta.



Më së shumti, audituesit e brendshëm shprehin nevojë për zhvillim profesional për llojet e ndryshme të auditimit të brendshëm, që do të thotë: kryerjen e auditimit të performancës (81% nevojë e lartë/moderuar), kryerjen e auditimit të sistemit të informacionit (90%), dhe kryerjen e auditimit të programeve dhe projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian (90%). Më shumë se mesatarja shprehin nevojë për të zhvilluar më tej vlerësimin e qendrimit të organizatës ndaj risqeve, vlerësimin e ekspozimit ndaj riskut dhe kontrollet në përgjigje të riskut, dhe metodat dhe teknikat e ndryshme në kryerjen e auditimit të brendshëm.

Intervistat kanë rikonfirmuar këto gjetje. Së pari, u vu re se auditimi financiar është lloji i auditimit më i zhvilluar në administratën publike shqiptare. Megjithatë, është e nevojshme, siç sugjerojnë të intervistuarit, të dallohet midis rekomandimeve për transaksionet financiare dhe rekomandimeve mbi performancën e përgjithshme të sistemeve financiare. Për më tepër, auditimi i performancës shihet si një sfidë madhore e cila ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, siç është rasti i auditimit të sistemeve të informacionit në kontaktin e digjitalizimit të administratës publike. Trajnime mbi si të jepen rekomandime specifike, në vend të atyre të përgjithshme, dhe për të përmirësuar gjuhën e raportimit janë shumë të nevojshme.



MENAXHIMI I POLITIKAVE PUBLIKE

Reformat në administratën publike vendosin theks të madh mbi procesin e menaxhimit të politikave publike – një proces që përfshin aktivitete të shumta dhe komplekse, nga identifikimi i problemeve ose tematikave që do të trajtojnë politikate e reja deri në vlerësimin e efekteve të tyre.

Pyetjet mbi menaxhimin e politikave publike i'u bënë vetëm menaxherëve të përgjithshëm. Rezultatet e kërkimit treguan se ekziston një numër i konsiderueshëm praktikash brenda këtij procesi që ata nuk i konsiderojnë si të lidhura me punën e tyre ose nuk kanë marrë pjesë në to deri më tani. Për më tepër, ka një numër praktikash që janë pjesë e fushës së menaxhimit të politikës publike, në të cilën të anketuarit shpehen se kanë nevojë të nivelit të lartë ose të moderuar për zhvillim të mëtejshëm profesional.

Aspekte të menaxhimit të politikave publike më shumë të nevojshme për zhvillim profesional (nga 65 në 80% të të anketuarëve)

Kryerja e analizave krahasuese të problemeve/zgjidhjeve për çështjet e ngjashme në shtete të tjera

Gjatë përcaktimit të çështjeve kyçe të politikës duke përdorur teknika të ndryshme analitike si pema e problemit, analiza SËOT, analiza PESTLE etj.

Identifikimi i palëve kyçe të interesuara dhe kryerja e analizës së palëve të interesuara (analizimi i nevojave të tyre, interesave, dhe kapaciteteve)

Identifikimi i supozimeve/faktorëve të jashtëm të cilët kanë potencial për të influencuar (ose dhe të përcaktojnë) suksesin e një projekti, por shtrihen jashtë kontrollit direkt të autoritetit publik

Shqyrtimi i aspekteve ligjore, organizative, manaxheriale, dhe institucionale të efekteve të opsioneve të konsideruara të politikës

Konsiderimi i skenarit “optimist” dhe “pesimist” i rezultatit të një opsioni politike të dhënë

Vënia në punë e teknikave sasiore si analiza kosto përfitim dhe analiza kosto efiçencë

Konsultimi me organet përkatëse të administratës publike ose shtetërore, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat shkencore dhe kërkimore

Intervistat treguan se ka nevojë për më shumë trajnim si të zhvillohen suksesshëm objektivat e politikës, të cilat në të njëjtën kohë gjendjen në eksperiencën të mëparshme dhe dijen që është akumuluar në administratën publike. U theksua se ka nevojë për komunikim dhe bashkëpunim më të madh mes njësive të ndryshme në një ministri të dhënë dhe midis ministrive të. Për më tepër, nëpunësit civilë kanë nevojë të trajnohen si të komunikojnë me palët e tjera të interesuara dhe si të përfshijnë këtë dije në mënyrë efektive në politikat e reja.

Mes sfidave më të rëndësishme të menaxhimit të politikave publike janë ato të lidhura me implementimin dhe monitorimin e politikës. U theksua se ka nevojë për më shumë harmonizim mes parimeve të politikës, strategjive, ligjeve dhe implementimit të politikës. Për më tepër, edhe pse ka zhvillime në fushën e monitorimit të politikës dhe vlerësimit të impaktit të politikës, ka nevojë për zhvillim të aftësive të nëpunësve civilë për të monitoruar dhe vlerësuar rezultatet e një politike të caktuar (në bashkëpunim me institucionet kërkimore), dhe në të njëjtën kohë të sigurohet pavarësia dhe objektiviteti i analizës.



RRETH PROJEKTIT

Titulli i projektit	Zhvillimi i Kurrikulave në Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike – FINAC
Partnerët e projektit	Universiteti i Beogradit, Serbi (institucioni koordinues) Universiteti Evropian i Tiranës, Shqipëri Universiteti i Shkodrës „Luigj Gurakuqi“, Shqipëri Universiteti i Kragujevacit, Serbi Universiteti Shtetëror i Novi Pazar, Serbi Universiteti Metropolitan, Serbi Universiteti in Split, Kroaci Universiteti Masaryk, Republika Çeke Universiteti Matej Bel, Sllovaki Universiteti Guglielmo Marconi, Itali Ministria e Administratës Publike dhe Vet- Qeverisjes Vendore, Republika e Serbisë Qendra për Politika në Arsim, Serbi
Koordinatori i Projektit / kontakti	Prof. dr Slađana Benković (Universiteti i Beogradit) coordinator@finac.org.rs
Koordinatori pranë Universitetit Evropian të Tiranës / kontakti	Blerjana Bino, PhD blerjana.bino@uet.edu.al
Koordinatori pranë Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi / kontakti	Prof.As.Dr. Blerta Dragusha bldragusha@yahoo.com
Programi	Ky projekt është bashkëfinancuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian. Numri i referencës së projektit 573534-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP
Kohëzgjatja e projektit	15.10.2016 – 14.10.2019.
Faqja web	http://www.finac.org.rs



*This project has been funded with support from the European Commission.
This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein*